

AKT THEMELIMI**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR****“WILD GARDEN” SH.P.K.****TITULLI I****THEMELIMI, EMËRTIMI, SELIA DHE KOHËZGJATJA****NENI 1 –THEMELIMI DHE EMËRTIMI**

Nëpërmjet këtij akti të krijuar sot më datë 1/3/2021 u identifikuan dhe u paraqitën personalisht ortakët themelues për krijimin e një shoqërie tregëtare “shoqeri me pergjegjesi te kufizuar “ si më poshtë “ortaket” :

1. ALTIN DHANAJ,i biri i Themi-ut dhe i Vasa, i datëlindjes 14.08.1977, vendlindja Elbasan, , dhe vendbanimi Elbasan , me shtetësi dhe kombësi shqiptare, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, I identifikuar nga pasaporta me numër BJ4197504 dhe numer personal H70814072M.
2. Nensi Dimo,bija e Dritan,dtl.23.6.1994, lindur ne Elbasan dhe banuese ne Elbasan, e idenitifikuar me karten e identitetit me numer personal J45623071G.
3. Dritan Dimo ,biri i Palush, dtl.26.7.1969, lindur ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, identifikuar me leternjoftim elektronik me numer personal G90726108Q.
4. Ilir Pashaj, biri i Dalip dhe Menduha, dtl.17.4.1971, lindur ne Lushnje e banues ne Elbasan, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, madhor dhe me zotesi te plote per te

vepruar, I identifikuar nga leternjoftimi elektronik me numër personal H10417167G dhe numer leternjoftimi 034738102.

Ortakët themelues të lartpërmendur vendos shprehimisht krijimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “WILD GARDEN” SH.P.K.

KRIJIMI

Pas bisedimeve dhe dakortesise verbale perpara nenshkrimit te ketij akt themelimi, te tre ortakët e mesiperm perfundimisht bien dakort te themelojne një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “WILD GARDEN”. Kjo shoqëri themelohet sot, në datë 1 /3/2021 sipas Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me ndryshimet.

Kjo shoqëri krijohet nga 4 ortakët themelues me contribute te ndryshme ne kapitalin themeltar.

NENI 2 –KOHËZGJATJA DHE LLOJI.

Shoqëria tregtare eshte ne formen e shoqërise me pergjegjesi te kufizuar.

Kohëzgjatja e shoqërisë është me nje afat te papercaktuar. Kjo shoqëri mund të përcaktojë nje afat te ndryshem me vendim të asamblesë së ortakëve, një ose disa herë.

NENI 3 –SELIA



Shoqëria ka selinë e saj ligjore në Elbasan, Bradashesh, rruga nacionale Elbasan-Peqin, 200 meter nga rrethrotullimi i Bradasheshit, pasuria nr.201/44/1-NDzona kadastrale 1258.....

Ajo mund të hapë seli dytësore, degë dhe përfaqësi në Shqipëri dhe jashtë saj, si dhe qendra të ushtrimit të aktivitetit .Selia ju behet me dije të tretteve , ortakeve , dhe Qendres Kombetare të Regjistrimit .Cdo njoftim zyrtar e me rendesi nga të tretet, shteti, dhe vete ortakët, behet me dije në këto adrese . Shoqëria njoftohet edhe në adresën elektronike, emailin që do të krijojnë ortakët, dhe që do të pasqyrojnë me regjistrimin në QKR.Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi mbahen nga të gjithë ortakët , dhe cdo kush që në të ardhmen do të ketë cilësinë e ortakut. Askush nuk mund të ndryshojë këto të dhëna pa pëlqimin e të gjithë ortakëve ndryshe behet objekt i përgjegjësive të cdo lloji.

NENI 4 –VENDBANIMI I ORTAKËVE

Vendbanimi ligjor i ortakëve për çdo dhe çfarëdo raporti me Shoqërinë, është ai që rezulton në librin e ortakëve.Per cdo ndryshim të vendbanimit, ortakët duhet të bëjnë me dijeni shoqërinë.Në rast të mosgjetjes së adresës së saktë të një ortaku , ose mosdhenies së adresës së saktë nga ana e tij, njoftimi duhet kryer në emailin e shoqërisë.

TITULLI II

OBJEKTI, KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT

NENI 5 –OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt kryesor të veprimtarisë së saj aktivitetet e mëposhtme : prodhimin, grumbullimin , Përpunimin,, , ruajtjen , ambalazhimin,Tregtimi me shumicë e

pakicë, import-eksport të mallrave ushqimore, si tartuf, kerpudha, vere, vaj, fruta, perime, agrume, dhe mallra me natyrë bujqesore e blegtorale, Mallrat industrial, kinkalerike..... etj.

NENI 6 –KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 4 000 000 (katërmilion) leke dhe është i ndarë në 4 kuota. Një kuota e barazvlefshme me 40 000 (dyzetmije) lekë dhe u përket ortakëve në këtë raport :

Altin Dhanaj : kontributi 1 880 000 (një milion e tetëqindetëdhjetë mijë) leke
zoterimi në përqindje 47 % , kuota 1

Nensi Dimo : kontributi 1 640 000 (një milion e gjashtëqind e dyzet mijë) leke ,
zoterimi në përqindje 41% , kuota 1

Dritan Dimo kontributi 400 000 (katërqindmijë) leke, zoterimi në përqindje 10% ,
kuota 1.

Ilir Pashaj , kontributi 80 000 (tetëdhjetëmijë) leke, zoterimi në përqindje 2% , kuota
1.

Kuotat janë të transferueshme. Transferimi i kuotave nga ortakët në favor të të tretëve bëhet pasi lajmërohen paraprakisht ortakët për transferimin dhe u jepet e drejta të

parablejne kuotat e ortakut qe ka ndermend te kryej transferim a tjetersim te kuotave .
Njoftimi duhet bere me shkim .

Të gjitha veprimet e shoqërisë mbi kapitalin bëhen vetëm me aprovimin e ortakëve, me vendim te shumices se ortakeve, por gjithsesi mjafton qe te kete votuar pro ortaku apo ortakët qe kane shumicen (mbi 50 perqind) te kuotave te shoqerise,pra qe votat pro te perbejne e perfaqesojne kete shumice te kuotave .

Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri. Bashkëzotëruesit e një kuote, sipas nenit 72 te ligjit nr 9901 “per tregetaret dhe shoqerite tregetare “ gëzojnë cilësinë si një ortak i vetëm.”.

TITULLI III

ADMINISTRIMI DHE REGJISTRIMI

NENI 7 –ADMINISTRIMI

Shoqëria do të ketë Administrator të saj Nensi Dimo me afat kohezgjatje 5vjet.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat e parashikuara nga ligji , me përjashtim të kompetencave që ligji ua jep shprehimisht ortakëve.Me miratimin e ketij akti, dhe te statutit,administratori cel llogarine bankare te shoqerise dhe manjehere derdhen ne te kontributet e te hollave sa me siper. Pas ketyre veprimeve administrative, administratori kryen regjistriin e shoqerise ne qendren kombetare te regjistrimit duke paqyruar ortkaerine dhe kuotat sipas raporteve te mesiperme per secilin ortak.Pergjegjesia e administratorit parashikohet ne ligjin e mesiperm nr. 9901 si dhe nga ligjet e aktet

nenligjore ne fuqi. Afati i ushtrimit te administratorit nis ditën e emerimit te tij dhe vijin per aq sa eshte afati i caktimit te tij nga mbledhja e asamblese se ortakeve.

Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblesë të përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

Te drejtat dhe detyrimet e administratorit parashikohen edhe nga stauti I shoqerise tregetare, por ne cdo rast I referohen ligjit ne fuqi ne teresi.

NENI 8 –REGJISTRIMI

Shoqeria fiton personalitet juridik , njeh te drejta e merr persiper detyrime, dhe behet pale ne qarkullimin civil ne vetem pas regjistrimit te sa ne regjistrin tregetar në Qendrën Kombëtare të Biznesit .

Për sa nuk jane hprehur ortaket ne kete statut , vlejne dispozitat ligjore , dhe cdo parashikim tjeter ne statutin e shoqerise tregetare.



NENI 9- TE TJERA

Ne rast mosmarreveshje ndermjet ortakeve dhe nuk ka mirekuptim ndermjet paleve, per zgjidhjen e tyre, kompetente do te jete Gjykata e Shkalles se Pare Elbasan.

Sa me siper te tre ortaket e kane shqyrtuar dhe lexuar kete akt themelimi, e kane kuptuar ate dhe e nenshkruajne pa bere verejtje.

ORTAKET THEMELUES

1. Altin Dhanaj

Altin Dhanaj

2.Nensi Dimo

Nensi Dimo

3.Dritan Dimo

Dritan Dimo

4.Ilir Pashaj

Ilir Pashaj

Elbasan date 1/3/2021.